



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА  
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_г./в.



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 nga Ligji për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë " Nr. 12/2019) neni 40 paragrafi 3 nga Rregullorja për punë të Komisionit Shtetërorë për Parandalimin e Korrupsionit, duke vepruar sipas denoncimit të parashtruar nga parashtrues i panjohur KSHPK (në tekstin e mëtejshëm) në seancën e76-të, të mbajtur më 25.10.2022, morri vendimin vijues:

### VENDIM

Veprimi ndaj lëndës me numër 12-1292/1 datë 24.03.2021, NDËRPRITET  
KSHPK-ja konstatoi se në bazë të pretendimeve nga denoncimi ka ndërmarrë masa dhe veprime nga një autoritet tjetër kompetent, për çka ka vlerësuar se nuk ka elemente për veprime të mëtutjeshme.

Lënda me numër 12-1292 të vitit 2021 të mbyllet dhe të arkivohet.

Vendimi i KSHPK-së, në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb - faqen e KSHPK-së brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimarrjes.

### Arsyetim

Lënda me numër 12-1292/1të datës 20.07.2021 është formuar në bazë të denoncimit të marrë nga parashtruesi panjohur. Në denoncim theksohet se transportuesi /// ka kryer transportin me autobus të udhëtarëve në itinerarin ///, pa pasur licencë të vlefshme për transportin. Theksohet se me datë 29.02.2020, transportuesi i lartpërmendur kishte licencë për transportin me autobus të udhëtarëve në linjën e përmendur, por pas skadimit të saj, transporti i udhëtarëve kryhej pa licencë. Thuhet se lidhur me rastin janë dorëzuar peticione në disa institucione kompetente, por në momentin e dorëzimit të denoncimit në KSHPK nuk kishte ndonjë zgjidhje konkrete për rastin. Denoncimi u përditësua radhazi më 04/07/2021, 04/13/2021, 06/01/2021 dhe 22/06/2021. Nga KSHPK-ja kërkohet ta rishqyrtojë këtë rast në përputhje me kompetencat e saj ligjore. Në shtojcë të denoncimit janë dorëzuar edhe dëshmi - tekste nga informacionet e disponueshme publikisht në lidhje me licencat e vlefshme të transportuesit të specifikuar.

Pas shqyrtimit të përmbajtjes së denoncimit dhe provave të dorëzuara, KSHPK-ja kërkoi veprime kompetente nga Ministria e Punëve të Brendshme të RMV-së. Ky autoritet ndërmori veprime në kuadër të kompetencës së tij ligjore, duke urdhëruar Inspektoratin Shtetëror të Transportit të RMV-së dhe Drejtorinë Doganore të RMV-së që të dorëzojnë të dhëna, informacione dhe dokumentacion në KSHPK. Nga këqyrja e dokumenteve të dorëzuara, KSHPK-

ja konstatoi se transportuesi në itinerarin e specifikuar ka kryer transport dy herë pa licencë të vlefshme, për ç'arsye Inspektorati Shtetëror i Transportit i RMV-së ka ndërmarrë veprimet e kërkuara inspektuese dhe se i janë shqiptuar dy gjopa transportues dhe dy gjopa për menaxherin e saj, kurse autobusi me të cilin janë transportuar udhëtarët është përjashtuar nga qarkullimi, të cilit i është hequr leja e komunikacionit. Pas skadimit të masave të inspektimit, transportuesi fitoi kushtet për marrjen e një leje të re për transportin me autobus të udhëtarëve në itinerarin e specifikuar, e cila është e vlefshme deri më 1 gusht 2026. Në anën tjetër, për rastin konkret procedurën e udhëheq Prokuroria Themelore Publike Kumanovë, për të cilën Drejtoria doganore e RMV-së ka njoftuar se të gjitha shkresat lidhur me rastin në fjalë janë dorëzuar në Ministrinë e Punëve të Brendshme të RMV-së, e cila ka ndërmarrë masa dhe veprime sipas urdhrit të lëshuar nga kjo prokurori. KSHPK-ja konstatoi se organet kompetente kanë ndërmarrë masa dhe veprime në bazë të pretendimeve nga denoncimi, për çka ka vlerësuar se rasti nuk ka elemente për veprim të mëtutjeshëm.

Bazuar në të theksuarën sa më sipër, KSHPK-ja vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Dorëzuar deri:  
Arkivi i KSHPK -së

Përgaditi: Mr D. D.

KOMISIONI SHTETËRORË  
PËR PARANDALIMIN E KORRUPTIONIT  
Kryetare,  
Biljana Ivanovska